



## **VENDIM I PAPRANUESHMËRISË**

**Data e miratimit: 4 shkurt 2014**

**Numri i lëndës: 2013-04**

**J**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 3 dhe 4 shkurt 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin e Llogaridhëns të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PARA PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 10 qershor 2013. Ankuesja ka kërkuar që emri i saj mos të bëhet publik. Paneli ka miratuar kërkësën e saj.

## **II. FAKTET**

2. Faktet e lëndës, siç janë parashtruar nga ankuesja, mund të përmblidhen si më poshtë;
3. Ankuesja pohon se ajo dhe vëllai i saj kanë pasur në pronësi një shtëpi dhe një ngastër të pronës së paluajtshme në Prishtinë. Ankuesja më tutje pretendon se në vitin 1999 këto prona përmes mashtrimit janë blerë nga një H.K., E.K. dhe N.K., të cilët më pas e kanë dëbuar vëllain e ankueses nga shtëpia. Vëllai i ankueses ka vdekur në vitin 2004.
4. Në një datë të pasaktësuar të vitit 2007, ankuesja ka parashtruar një kërkesë në gjykatën komunale në Prishtinë, ku ka kërkuar që kontrata e shitjes të shpallet e pavlefshme.
5. Më 15 dhjetor 2010, gjykata komunale në përbërje të një trupi gjykatësish të përzier prej gjykatësve të EULEX-it dhe të Kosovës e ka miratuar kërkesën e ankueses.
6. Të pandehurit kanë parashtruar një ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë, duke argumentuar se gjykata komunale kishte shkelur të drejtën procedurale dhe materiale dhe gabimisht kishte vërtetuar faktet e lëndës.
7. Më 13 dhjetor 2010, gjykata e qarkut në Prishtinë në përbërje të një trupi gjykatësish të përzier prej gjykatësve të EULEX-it dhe të Kosovës kishte prishur vendimin e kontestuar dhe kishte dërguar lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim. Gjykata e qarkut ka gjetur se kishte pasur shkelje të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar të fakteve dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e qarkut *ndër të tjera* ka konsideruar se ankuesja nuk kishte qenë pjesë e procedurave, pasi ajo nuk ishte palë e kontratës së shitjes dhe as nuk ishte pasardhëse ligjore e vëllait të saj.
8. Paneli mendon se procedurat në këtë lëndë tanë për tanë janë të pazgjidhura para gjykatës së shkallës së parë.

## **III. ANKESAT**

9. Ankuesja pohon se për shkak të tej zgjatjes së procedurave gjyqësore dhe gabimeve të kryera nga gjykatat, sistemi i drejtësisë në Kosovë ka dështuar që të mbrojë në mënyrë efektive të drejtat e saja në pronësi.

## **IV. LIGJI**

10. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut, siç pasqyrohet në Konceptin e Llogaridhënieve së EULEX të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e

Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standarde minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të jenë të garantuara nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

11. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
12. Sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtësi, policisë dhe doganë.
13. Paneli rithekson se, në bazë të rregullës 25, paragrafi 1, bazuar në konceptin e llogaridhënieve në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, nuk mund të shqyrtojë procedurat gjyqësore që janë para gjykatave të Kosovës. Nuk ka juridiktion rreth aspekteve administrative e as aspekteve gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës. Paneli tashmë ka gjetur në mënyrë të përsëritur që fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të çfarëdo gjykate nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih midis të tjera: *Gani Zeka kundër EULEX-it*, nr. 2012-02; § 21; *Z kundër EULEX-it*, nr. 2012-06, § 31).
14. Paneli vijon se këto ankesa nuk hyjnë në kuadër të mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN të EULEX-it në Kosovë.

### PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën, pasi ajo bie jashtë juridikzonit të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së punës, dhe

### SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese